



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.21 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Memorandumin e Bashkëpunimit për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për ndjekjen e kryerësve të veprave penale edhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe Planin Strategjik për bashkëpunim ndërinstitucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe nenin 8 të Udhëzimit administrativ Nr.01/2023 për hartimin e akteve normative të KPK-së, më 30 prill 2025 miraton:

**RREGULLORE NR. 04/2025**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR THEMELIMIN**  
**DHE FUNKSIONALIZIMIN E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E**  
**KRIMIT EKONOMIK**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për themelimin dhe funksionalizimin e Koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomik (Në tekstin e mëtejme: Koordinatori kombëtar për luftimin e krimit ekonomik), me qëllim të përcaktimit të mandatit, vlerësimit të punës së Koordinatorit dhe përgjegjësitë e tjera të parapara sipas memorandumit.

**Neni 2**

Plotësohet dhe ndryshohet titulli i **nenit 7** si në vijim:

**Mbikëqyrja, mandati dhe vlerësimi i punës së Koordinatorit Kombëtar**

**Neni 3**

**Neni 7** plotësohet si në vijim:

Paragrafi 6: mandati i Koordinatorit Kombëtar është 3-vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat pas vlerësimit pozitiv të punës.

Paragrafi 7: Këshilli Prokurorial i Kosovës për çdo vit e bën vlerësimin e punës së Koordinatorit Kombëtar, bazuar në përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara me Rregullore, përmes një komisioni të themeluar nga ana e tij në përbërje prej 2 anëtarëve të Këshillit dhe 1 prokuror nga ZKPSH-ja.

#### **Neni 4**

Shtohet **neni 9**, kurse neni 9 ndryshohet dhe bëhet 10.

#### **Neni 9**

##### **Dispozitat kalimtare**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Këshilli Prokurorial i Kosovës me vendim cakton Koordinatorin sipas mandatit të paraparë në këtë rregullore.

#### **Neni 10**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 30 prill 2025



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës